



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.395, datë 14.12.2023

PËR

“ZËVENDËSIMIN E PROKURORIT ARTUR CARA ME PROKURORIN YLLI
PJETËRNIKAJ SI KËSHILLTAR LIGJOR PËRGJEGJËS
PËR VLERËSIMIN”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, 164, pika 8, 184, germa “dh” dhe 189, pika 1 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve”, Vendimin Nr.375, datë 30.11.2023 “Për komandimin e prokurorit në pozicionin e Këshilltarit Ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, si dhe me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Zëvendësimin e prokurorit Artur Cara me prokurorin Ylli Pjetërnikaj, në procedurat administrative të papërfunduara, në të cilat zoti Artur Cara është caktuar për trajtim.
2. Të njoftohet për këtë vendim zoti Ylli Pjetërnikaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 14.12.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro